



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA

GJAKOVA



Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 20.05.2024

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.2) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 63 (paragrafi 63.1.2) të Rregullores për Prokurim Publik të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 15.05.2024, të parashtruar nga Operatori ekonomik PRINCI COMPANY SH.P.K., lidhur me aktivitetin e prokurimit "Asgjësimi i barnave", Nr. i prokurimit- Nr. i prokurimit- 632-24-1678-2-2-1, Nr. i brendshëm-632-24-018-221, nxjerr:

V E N D I M

1. Aprovohet si pjesërisht e bazuar kërkesa për ri-shqyrtim e Operatorit Ekonomik PRINCI COMPANY SH.P.K., e dt.15.05.2024, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Asgjësimi i barnave", Nr. i prokurimit- Nr. i prokurimit- 632-24-1678-2-2-1, Nr. i brendshëm-632-24-018-221, kundër NJOFTIMIT MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, të publikuar me datë 13.05.2024, të publikuar në platformën elektronike të KRPP-së.

2. Anullohet NJOFTIMI MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, i publikuar me datë:13.05.2024;

3.Autoriteti Kontraktues, vendos që ta kthejë lëndën në ri-vlerësim.

4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe publikohet në platformën elektronike të KRPP-së .



Arsyetim

Operatori Ekonomik PRINCI COMPANY SH.P.K., me dt.15.05.2024, ka parashtruar kërkesës për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Asgjësimi i barnave", Nr. i prokurimit- Nr. i prokurimit- 632-24-1678-2-2-1, Nr. i brendshëm-632-24-018-221.

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me datë 20.05.2024, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Pretendimet e juaja janë pjesërisht të bazuara, prandaj Autoriteti kontraktues do ta kthejë lëndën në ri-vlerësim.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si në dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së . Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.

Kopje: Operatorit Ekonomik;
Zyrës së Kryetarit te Komunës;
Te gjitha palëve te interesuara;

